



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



RAPORT MONITORUES PËR KEK

**INVESTIMET KAPITALE-SHPENZIMET OPERATIVE DHE PËRFORMANCA E TË
LICENCUARVE PËR PERIUDHËN 2013-2015**

Dhjetor 2016



Përmbajtja:

1. HYRJE.....	4
1.1 Përmbledhje ekzekutive.....	4
1.1 Sektori i rregulluar – metodologjia.....	6
2. Monitorimi i investimeve kapitale dhe shpenzimeve operative në Gjeneratorët e KEK Sh.A.....	7
2.1 Investimet Kapitale në TC Kosova A.....	7
2.2 Ndikimi i investimeve kapitale në parametrat e performancës	9
2.3 Investimet në TC Kosova B.....	10
2.4 Ndikimi i investimeve kapitale në parametrat e performancës	12
2.5 Kostot Operative –TC KOSOVA A	13
2.6 Kostot Operative – TC Kosova B.....	14
2.7 Prodhimi i enenergjisë elektrike	14
2.8 Ndërprerjet e planifikuara dhe pa-planifikuara	15
3. Kostot Kapitale dhe Operative në Miniera.....	16
3.1 Investimet Kapitale	16
3.2 Shpenzimet operative në Miniera.....	18
3.3 Prodhimi dhe konsumi i linjitit.....	19



Shkurtesat:

BRE	Burimet e Ripërtërishme të Energjisë
CAPEX	Capital Expenditures (Shpenzimet kapitale)
FP	Furnizuesi Publik
GWh	Gigavatorë
HC	Hidrocentral
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KEDS	Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike
KOSTT	Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut
kV	Kilovolt
kW	Kilovat
LP	Largpërçues
MAR	Të Hyrat Maksimale të Lejuara (HML)
MW	Megavat
MWh	Megavatorë
NS	Nënstacioni
OPEX	Operational Expenditures (Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes)
OSSH	Operator i Sistemit të Shpërndarjes
OST	Operator i Sistemit të Transmisionit
OT	Operator Tregu
RoR	Rate of Return (Norma e kthimit)
RAB	Regulated Asset Base (Baza e Rregulluar e Aseteve)
SCADA	Supervisory Control and Data Acquisition (Sistemi Mbikëqyrës dhe i Mbledhjes së të Dhënave)
Sh.A	Shoqëri aksionare
TC	Termocentral
TL	Tensioni i lartë
TR	Transformator
TM	Tensioni i Mesëm
TU	Tensioni i Ulët
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
ZRRE	Zyra e Rregullatorit për Energji



1. HYRJE

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), në pajtim me kompetencat dhe obligimet e përkufizuara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe në Rregullën për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë ka ndërmarr monitorimin e ndërmarrjeve të licencuara energjetike në Kosovë për periudhën raportuese 2013-2015. Në harmoni me këto ligje ZRRE ka themeluar grupe punuese për monitorimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të tilla. Një ndër këto grupe është edhe grupi punues për monitorim e investimeve kapitale, shpenzimeve operative dhe indikatorëve të tjerë të performancës të të licencuarve KEK, KOSTT, KEDS dhe KESCO.

Stafi i ZRRE-së, gjatë muajit shtator 2016 ka mbajtur takime me menaxhmentin e KEK-ut, KEDS/KESCO dhe të KOSTT-it lidhur me investimet kapitale të implementuara në sektorin e energjisë, shpenzimet operative të realizuara si dhe performancën e ndërmarrjeve në sektor. Me qëllim të shmangies së paqartësive eventuale të të dhënave dhe të gjeturave të prezantuara në këtë raport, ZRRE paraprakisht e ka dërguar në KEK draftin fillestar për komentim.

1.1 Përmbledhje ekzekutive

Pas të gjitha analizave, grupi punues i këtij raporti, ka paraqitur të gjeturat kryesore rreth investimeve kapitale dhe shpenzimeve operative të KEK-ut. Duhet të theksohet se sipas legjislacionit të aprovuar në gusht të viti 2016, gjenerimi i energjisë elektrike do të liberalizohet, që do të thotë se çmimi i gjenerimit nuk do të rregullohet nga ZRRE.

Ky raport do të shqyrtohet në detaje gjatë procesit të përshtatjeve të rregullta vjetore.

Të gjeturat kryesore për shqyrtim nga Bordi i ZRRE-së janë si në vijim:

- Në bazë të të dhënave të prezantuara nga KEK - Gjenerimi, vërehet se shpenzimet kapitale të gjenerimit nuk janë të planifikuara në mënyrë të kujdesshme. Në përgjithësi shpenzimet kapitale të gjenerimit janë realizuar në nivelin prej 81% në raport me investimet e lejuara nga ZRRE.
- Në bazë të analizave të bëra me të dhënat e prezantuara nga KEK - Miniera, është konstatuar që shpenzimet kapitale të Minierave nuk janë të planifikuara dhe të realizuara në harmoni me lejet nga ZRRE, sipas shqyrtimit tarifor shumëvjeçar.
- ZRRE konstaton se shpenzimet e mirëmbajtjes, riparimeve dhe furnizimeve me materiale në TC Kosova B janë realizuar në nivel më të ulët se niveli i lejuar. Mosrealizimi i



shpenzimeve të riparimeve, mirëmbajtjes dhe materialeve është i papranueshëm, kur merren parasysh vjetërsia teknike e termocentraleve si dhe nevoja për mirëmbajtjen në mënyrë rigoroze ashtu që të mund të përmbushin kërkesat e konsumit për energji elektrike.

- Analiza krahasuese e shpenzimeve operative për njësitë gjeneruese, tregojnë që KEK ende nuk ka arritur që gjeneratorët TC Kosova A dhe TC Kosova B t'i trajtoj si të ndarë. Kjo ka shkaktuar edhe devijime në kategori të ndryshme të shpenzimeve të përgjithshme.
- Arsyeshmëria e KEK-ut për mos realizim të projekteve të planifikuara ka ardhur nga shkaqe të ndryshme duke filluar nga procedurat ligjore të prokurimit, vështirësitë financiare e deri te prioritetet e rastit për projekte. Vlen të theksohet se për këtë periudhë janë lejuar rreth 96 mil€, ndërsa janë realizuar rreth 25 mil€ apo janë realizuar investimet kapitale në normën prej 26%.
- Arsyetimet e KEK për mos realizimin e investimeve në miniera dhe arsyetimet për vështirësitë financiare nuk qëndrojnë duke pasur parasysh faktin se në dy vitet e fundit KEK ka realizuar bilanc pozitiv financiar i cili do të duhej shfrytëzuar për realizimin e investimeve të lejuara nga ZRRE.



1.2 Sektori i rregulluar - metodologjia

Ne sektorët e rregulluar, te hyrat e lejuara maksimale përcaktohen nga rregullatori ashtu që të licencuarit ti mbulojnë kostot e tyre të arsyeshme për ofrimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve. Ngarkesat (çmimet) dizajnohen ashtu që të mbulojnë kostot për ofrimin e këtyre shërbimeve.

Ne kuadër të të hyrave të lejuara janë edhe kostot që kanë të bëjnë me investimet kapitale. Metodologjia në bazë të cilës njihen kostot e të licencuarve përmbajnë elemente të performancës ashtu që secili operator nxitet të bëjë investimet e duhura duke i mundësuar kthim të arsyeshëm për investimet e bëra.



Figura 1-RoR (Kthimi i rregulluar)

Norma e kthimit (WACC) aprovohet nga rregullatori dhe aplikohet më pastaj ndaj vlerës së investimeve kapitale (CAPEX-it) për të kalkuluar kthimin e lejuar.

Duke qenë ky sektorë të rregulluar, rregullatori i energjisë siguron që interesat e kompanisë dhe konsumatorëve të jenë të balancuara. Norma e kthimit për investime aprovohet nga rregullatori për periudhë rregullative (4-5 vite) dhe ajo garanton që operatori të sigurojë fitim të rregulluar të arsyeshëm dhe konsumatorët të përfitojnë në kualitetin e shërbimit.

Me poshtë është paraqitur figurativisht nxitja e investimeve përmes normës së kthimit dhe balancimi i interesave ndërmjet kompanisë dhe konsumatorëve nëpërmjet rregullimit.



Figura 2-Rregullimi



2. Monitorimi i investimeve kapitale dhe shpenzimeve operative në Gjeneratorët e KEK Sh.A

2.1 Investimet Kapitale në TC Kosova A

Shpenzimet kapitale për TC Kosova A dhe TC Kosova B janë klasifikuar në dy kategori kryesore: investimet që ndihmojnë mbajtjen në funksion të impianteve dhe investimet që kanë të bëjnë në mbrojtjen e ambientit.

Në TC Kosova A investimet kapitale të lejuara janë realizuar pjesërishtë me dinamikën e planifikuar, megjithatë ka projekte kapitale që janë realizuar jashtë lejlimeve të ZRRE-së për shkak të avarisë së ndodhur në Repartin e Elektrolizës në Qershor të vitit 2014.

Duke krahasuar vlerat e realizuara me ato të lejuara për periudhën përkatëse, vërehet që TC Kosova A ka realizuar 31 mil€ të investimeve kapitale nga 23 mil€ në vitin 2013, apo në normën prej 132%, në vitin 2014 ka realizuar 9.8 mil€ të investimeve kapitale nga 17.7 mil€ apo në normën prej 55%, dhe në vitin 2015 ka realizuar 8.9 mil€ të investimeve kapitale nga 10.2 mil€ apo në normën prej 87 %.

Vlen të theksohet se për këtë periudhë janë lejuar rreth 50.9 mil€, ndërsa janë realizuar 49.1 mil€ apo në normën prej 95%. Vlera e investuar është me financim vetanak.

Në tabelën e mëposhtme shihet krahasimi i investimeve kapitale të lejuara në raport me realizimin e investimeve kapitale në TC Kosova A për periudhën e raportuar 2013- 2015.

Emrat e projekteve	2013		2014		2015	
	Lejuar (€'000)	Aktual (€ '000)	Lejuar (€'000)	Aktual (€ '000)	Lejuar (€'000)	Aktual (€ '000)
Paisjet per monitorimin e ambientit per njesine A3	900					
Kompresoret e ajrit per TC A	3,037	3,037				
TCA - 2620 Running meters @ 168 € (Inclusive of 4 High-rise fencing gates)	440					
Kamerat e vezhgimit	14					
Makina zjarrefikese	130	118				
Riparim kapital i njesise A4	10,000	7,608				
Filtrat elektrostatik per njesine A4	8,497	8,900				
Pompat furnizuesete kaldajes A3, me shpejtesi te ndryshusheme levizese			1,960			
Pompat furnizuesete kaldajes A4, me shpejtesi te ndryshusheme levizese					1,960	-
Instalimi i ekranit të ftohësit të ujit për A3, A4, & A5.			750		750	-
Rip.kap.A5(T+GJ+Tj)			10,000	5,272		
Riparim vjetor i A3,A4			5,000	3,716		
Riparim vjetor i A3,A4,A5					7,500	4,225
Riparimi kapital Kaldajes Bll A3		1,341				
Ndrrimi elektrofiltrave Bll A3		1,335				
Sanimi i sipërfaqeve te konstrukcionit të A5		231				
Kaldaja e A3		837				
Turbina e A3		632				
Transformatori trefazorë dhe Riparimi I kushinetave të dyfishta		882				
Projekte tjera te prioritetit te lartë të realizuara gjatë vitit 2013		5,537				
Riparimi i kullës ftohëse në Bll.A4				158		
Riparimi i oxhakut në bll.A4,A5				45		
Nivilizimi i kotës +0 m në kaldajen e Bll A3/A4/A5.				200		
Ndërtimi I Platëformës për Ramp.				10		
Sanimi I Qarjeve në Kaden e Kullës ftohëse				5		
Stabilimentet elektrike 35kV-				85		
Stabilimentet elektrike 6Kv-				60		
Stabilimentet elektrike gjenerator				60		
Rregullimi i rrethojës rreth trafove				23		
Riparimi i qarqeve rregulluese				57		
Marrja e O2 në një kanal në Bll. A4.				15		
Qarku rregullues për Bll.A5.				23		
Sistemet elektrike matje mbrojtje Bl. A4				86		
Stabilimentet elektrike 35kV						45
Liferimi i bllok transformatorit per GJ-5 me te dhena:						1,000
Pompat furnizuese						689
Asfaltimi i rrugëve kundër zjarrit përreth objektit të TC-A						45
Kontrata per Transportin Hidraulik te Hirit neTC A nga vitet paraprake te parealizuara, qe paguhen ne 2015						1,560
Pune shtese per riparime te turbo-gjeneratorit në Bll.A4 dhe A5						1,302
Gjithsej	23,018	30,458	17,710	9,815	10,210	8,866

Tabela 1-CAPEX 2013-2015 për TC Kosova A

2.2 Ndikimi i investimeve kapitale në parametrat e përfomancës

Në vijim janë paraqitur përshkrimet teknike të projekteve të realizuara për këtë periudhë, arsyeshmëria, ndikimi në performancën e sistemit, objektivat dhe benefitet që arrihen me realizimin e tyre. Më poshtë janë paraqitur projektet kryesore të realizuara në këtë periudhë:

- **Projekti “Kompresorët e ajrit për njësi”** është realizuar në tërësi në vitin 2013. Realizimi i projektit ka dhënë rezultate në përmirësimin e stabilitetit të turbinave dhe funksionimit të instrumenteve pneumatike. Këto pajisje kanë rol vital në mbarëvajtjen e procesit të prodhimit.
- **Projekti “Remonti Kapital në njësinë A4”** është filluar në vitin 2013 dhe ka mbaruar në fillim të vitit 2014. Remontet kapitale janë periodike dhe të domosdoshme për të vazhduar jetëgjatësia e blloqeve. Me këtë rast është rritur stabiliteti dhe siguria e gjeneratorit, është lehtësuar operimi dhe është rritur shkalla e koeficientit të shfrytëzimit të kapacitetit të prodhimit.
- **Projekti “Filtrat e rinjë elektrostatik për Njësinë A4”** i investuar në vitin 2013 i paraparë në vlerë prej 8.5 mil€, është realizuar në vlerë prej 8.9 mil€ ku është tejkaluar vlera prej 0.4 mil€ për shkak të disa punëve shtesë rreth stabilitetit të tij fizik. Me këtë projekt është arritur të përmirësohet ambienti për rreth termocentralit, është zvogëluar imitimi i gazrave SO₂, NO_x dhe CO₂. Me këtë rast është plotësuar një standard i kërkuara nga BE kundër ndotjes së ambientit dhe po ashtu është përmirësuar ambijenti për banorët rreth këtij Termocentrali.

Gjatë vitit 2013, në total, ka pasur tejkalime të realizimit të projekteve kapitale në vlerë prej 7.4 mil€. Kjo ka rezultuar si pasojë e intervenimit në bllokun A3 në riparimin kapital të Kaldajës, riparimit të Transformatorit trefazorë dhe kushinetave të dyfishta dhe projekteve te prioritetit të lartë të realizuara në vitin 2013.

- **Projekti “Riparimi i pompave furnizuese për kaldajë”** është shtyrë së realizuari për shkak të avarisë së ndodhur në Qershor të vitit 2014.
- **Remonti kapital në njësitë e TC A** gjatë periudhës 2013-2015 janë realizuar sipas planifikimit dhe pjesa tjetër e investimeve kanë ndodhur si domosdoshmëri e operimit pas dëmtimeve të ndodhura si pasojë e aksidentit në repartin e elektrolizës të TC Kosova A. Investimet janë realizuar në turbinë, gjenerator dhe pajisjet tjera përcjellëse të njësisë A4 ka ndikuar në stabilizimin e prodhimit të energjisë elektrike, në rritjen e gatishmërisë teknike dhe rritjes së disponueshmërisë.

Gjatë vitit 2014 dhe 2015 janë realizuar edhe projekte shtesë si pasojë e avarisë së Qershorit 2014, në vlerë prej 5.5 mil€. Vlen të cekën projektet shtesë për riparime të turbo-gjeneratorit në bllokun A4 dhe A5 në vlerë prej 1.3 mil€, transporti hidraulik i hirit në TC



Kosova A prej 1.5 mil€, si dhe liferimi i Bllok-transformatorit për bllokun A5 në vlerë prej 1.0 mil€. Këto investime kanë ndikuar drejtpërdrejt në stabilitetin e punës së bllqeve, rritjen e sigurisë në operim dhe rritjen e prodhimit të energjisë elektrike.

2.3 Investimet në TC Kosova B

Në Planin Investiv 4 vjeçar për periudhën 2013–2016 janë lejuar investime kapitale për mbajtësin e licencës për bashkëprodhim të energjisë elektrike dhe termike, TC Kosova B, të cilat investime kanë kontribuar në besueshmërinë dhe stabilitetin e disponueshmërisë së njësive gjeneruese.

Duke krahasuar vlerat e realizuara me ato të lejuara për periudhën përkatëse, vërehet se në TC Kosova B në vitin 2013 janë realizuar 1.9 mil€ të investimeve kapitale nga 9.1 mil€, e shprehur në përqindje 21 %; në vitin 2014 janë realizuar 9.2 mil€ të investimeve kapitale nga 5.5 mil€, e shprehur në përqindje 167 %; dhe në vitin 2015 janë realizuar 6.0 mil€ të investimeve kapitale nga 16.5 mil€, e shprehur në përqindje 36.6 %.

Vlen të theksohet se për këtë periudhë janë lejuar rreth 31.1 mil€, ndërsa janë realizuar 17.1 mil€ apo janë realizuar investimet kapitale në normen prej 55%. Vlera e investuar është me financim vetanak edhe nga kreditë.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur lista e projekteve kapitale të lejuara nga ZRRE dhe realizimi i tyre sipas viteve në TC Kosova B për periudhën e 2013-2015.

Emrat e projekteve	2013		2014		2015	
	Lejuar (€'000)	Aktual (€ '000)	Lejuar (€'000)	Aktual (€ '000)	Lejuar (€'000)	Aktual (€ '000)
Rrethoja të sigurisë per TC Kososva B	428					
Kamerat e vezhgimit	14					
Makinat zjarrfikese	130					
KF, oxhaku, dhe tjera	6,000	1,871				
Mbeshjtjellesi i jashtëm i turbines se presionit te larte te njesise B1			3,500	6,699		
Remont i njesise B2 – remont capital pesevjeqar					13,000	
Modernizimi I transmisionit te sistemit te mullinjeve(16 mullinje)	2,500		2,000		3,500	335
Puna SH J HP, riparimet e trubines HP						
Riparimi I dy rotoreve per pompa furnizuese				59		
Riparimi I pompes se kondenzatit				326		
Blerja e rreshirave per demineralizim				391		
Pastrimi I siperfaqeve ngrohëse				74		
Pastrimi I siperfaqeve hojeve				38		
Furnizimi me motorë 6,3kV				160		
Riparimi gjeneral i trafo AT dhe montimi ne B1.				207		
Blerja e ftohësve te hidrogjenit ne gjenerator (3 copë)				62		
Ndërrimi I gypave të ekonomajzerit Bll. B1				408		
Pajisjeve për ventilimin e punëtorisë Mekanike ne TC B,				34		
Ripar i xhuntave hidridinamike VOITH te pompes fur.				735		
Puna per nderrimin e shtepizes se jashtme HP, riparimet e servomotorave, shqyrtimet metalografike dhe jetegjatesise se komponenteve te trubines HP						1,583
Furnizimi me motorra 6,3kV						160
Riparimi gjeneral i trafos AT (rezerve) dhe montimi ne B1.						378
Riparimi i xhuntave hidridinamike VOITH te pompes furnizuese (Kontrata eshte e lidhur nga 2011. Ne vitin 2013 paguhen mbetjet)						537
Blerja e ftohësve te hidrogjenit ne gjenerator (3 copë)						932
Ndërtimi i rrjetit të ri për uji te pijshem						38
Riparimi i 2 rotorave te Pompave furnizuese						612
Ormanat mbrojtjes per shndrruesit frekuencor te dhensave te thengjillit						20
Furnizim me Bulldozher						259
Ambienti i punes se mirembajtjes (ish garderoba)						61
DCS up grade						686
Ndrrimi i gypave te EKOS ne B2						296
Ndrrimi i mbajtesave te gypave te SMT ne njesin B1						145
Gjithsej	9,072	1,871	5,500	9,193	16,500	6,042

Tabela 2-CAPEX 2013-2015 për TC Kosova B

2.4 Ndikimi i investimeve kapitale në parametrat e përfomancës

Në vijim janë paraqitur përshkrimet teknike, arsyeshmëria e projekteve, ndikimi në performancën e sistemit, objektivat dhe benefitet që arrihen me realizimin e investimeve kapitale në TC Kosova B:

- **Projekti Kulla Ftohëse, Oxhaku** dhe të tjerat janë paraparë të zhvillohen gjatë vitit 2013 dhe buxheti për këtë ishte planifikuar të jetë 6.0 mil€, ndërsa është realizuar prej 1.9 mil€. Ky projekt ka qenë i rëndësishëm për mbarëvajtje të prodhimit dhe esencial për ftohje të blloqeve. Oxhaku dhe kulla ftohëse është i përbashkët për të dyja njësitë gjeneruese të TC Kosova B (B1 dhe B2).
- **Projekti për Turbinën e trusnisë së lartë në njësinë B1** ishte planifikuar të realizohet gjatë vitit 2014 në shumë prej 3.5 mil€. Ky projekt është realizuar në kuadër të afateve kohore të parapara gjatë vitit 2014 por me një kosto më të ulët, përkatësisht në shumë prej 6.7 mil€.
- **Remonti kapital (pesëvjeçar) i njësisë B2** Ky projekt i planifikuar nuk është realizuar në vitin 2015, vlera e këtij projekti të lejuar nga ZRRE është 13 mil€. Remonti kapital që bëhet çdo pesë vite planifikohet të realizohet në shtatë vite si nëse njësia përkatëse është në gjendje stabile të operimit, andaj edhe investimet e parapara të bëhen për vitin 2015 mund të zhvendosen në vitin 2017.

Për shkak të kufizimeve financiare dhe nevojave urgjente të cilat janë shfaqur ndërkohë gjatë operimit, disa projekte janë zëvendësuar. Projekte shtesë të cilët nuk kanë qenë të parapara me planin investiv 2013 – 2016 janë realizuar në shumë prej 8.2 mil€ përgjatë kësaj periudhe.

Projektet e realizuara në TC Kosova B, kanë ndikuar pozitivisht në stabilitetin e njësive gjeneruese, në disponueshmërinë e tyre, uljen e konsumit specifik të thëngjillit, uljen e konsumit të derivateve të naftës (mazutit) dhe uljen e rënieve të paplanifikuara të njësive gjeneruese.



2.5 Kostot Operative –TC KOSOVA A

KEK ka prezantuar të dhënat për shpenzimet operative të realizuara për periudhën 2013- 2015 për TC Kosova A. Raporti i monitorimit për këtë periudhë është bërë duke krahasuar të dhënat e realizimit të shpenzimeve operative me ato të lejuara në shqyrtimin shumë-vjeçar.

Vlerësimet e shpenzimeve operative të lejuara janë bërë duke marr parasysh vlerat historike dhe të parashikuara të zërave përkatës buxhetore 2008-2016; arsyetimin teknik për secilin zë buxhetor; shpjegim shtesë të ofruara nga i licencuari, krahasimet me kompanitë e ngjashme etj.

Shpenzimet e përgjithshme operative të lejuara për TC Kosova A për periudhën e raportuar 2013-2015 janë 43.0 mil€, ndërsa janë realizuar 47.9 mil€. Duke i krahasuar këto të dhëna, vërehet që realizimi i shpenzimeve operative për këtë periudhë arrin në 112 %.

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë detajet për shpenzimet operative të lejuara dhe realizuara sipas zërave për periudhën 2013-2015.

Përshkrimi	Njesia	Lejuar 2013	Realizuar 2013	Lejuar 2014	Realizuar 2014	Lejuar 2015	Realizuar 2015	Lejuar 2013-2015	Realizuar 2013- 2015	Realizimi %
Shpenzimet e pagave	€'000	6,876	9,069	5,115	9,395	4,546	9,838	16,537	28,302	171%
Derivatet gasi uji	€'000	6,399	3,631	5,665	1,392	4,723	3,176	16,786	8,199	49%
Riparimet dhe mirëmbajtja	€'000	2,766	2,912	2,139	1,999	1,328	1,553	6,233	6,464	104%
Shpenzimet e transportit	€'000	37	25	29	35	27	3	93	63	68%
Shpenzime sigurimit	€'000	395	458	306	316	281	475	982	1,249	127%
Shpenzime tjera	€'000	962	1,932	745	806	685	970	2,392	3,708	155%
Total	€'000	17,435	18,027	13,998	13,943	11,590	16,015	43,024	47,985	112%

Tabela 3- Kostot e operimeve dhe të mirëmbajtjes TC A



2.6 Kostot Operative – TC Kosova B

Shpenzimet e përgjithshme operative të lejuara për TC Kosova B për periudhën e raportuar 2013- 2015 janë 37.7 mil€, ndërsa realizimet janë milion 38.8 mil€. Duke i krahasuar këto të dhëna, vërehet se realizimi i shpenzimeve operative për këtë periudhë arrin në 103%.

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë detajet për shpenzimet operative të lejuara dhe realizuara sipas zërave për periudhën 2013-2015.

Përshkrimi	Njesia	Lejuar 2013	Realizuar 2013	Lejuar 2014	Realizuar 2014	Lejuar 2015	Realizuar 2015	Lejuar 2013-2015	Realizuar 2013- 2015	Realizimi %
Shpenzimet e pagave	€'000	4,584	6,124	4,075	6,389	4,128	6,896	12,787	19,409	152%
Derivatet gasi uji	€'000	4,278	3,331	3,857	3,429	3,670	2,836	11,805	9,596	81%
Riparimet dhe mirëmb	€'000	3,123	2,806	2,772	2,259	2,809	1,869	8,704	6,934	80%
Shp e transp.ortit	€'000	107	26	95	23	96	22	297	71	24%
Shpenzime sigurimit	€'000	284	163	252	216	255	204	790	583	74%
Shpenzime tjera	€'000	1,191	1,065	1,059	550	1,073	545	3,323	2,160	65%
Gjithsejt	€'000	13,567	13,515	12,109	12,866	12,031	12,372	37,707	38,753	103%

Tabela 4- Kostot e operimeve dhe të mirëmbajtjes TC Kosova B

2.7 Prodhimi i enenergjisë elektrike

Prodhimi i neto i energjisë elektrike për vitin 2013 është 5,719 GWh që ka qenë vit rekord që prej operimit të KEK gjenerimit, në vitin 2014 prodhimi i energjisë elektrike ka qenë më i ulët për shkakë të shpërthimit në TC Kosova A dhe është realizuar prej 4,742 GWh, ndërsa prodhimi i energjisë elektrike në vitin 2015 ka qenë 5,361 GWh.




Figura 3-Prodhimi i energjisë elektrike 2013-2015

2.8 Ndërprerjet e planifikuara dhe pa-planifikuara

Numri i daljeve nga operimi është njëri ndër indikatorët e funksionimit të njësive gjeneruese. Këto ndalje mund të ndahen në ndalje të planifikuara, të paplanifikuara dhe rënie, të cilat për periudhën 2013-2015 janë të paraqitura në tabelën e më poshtme.

TC Kosova A&B	Viti 2013					Viti 2014					Viti 2015				
	A3	A4	A5	B1	B2	A3	A4	A5	B1	B2	A3	A4	A5	B1	B2
Ndalesat e Planifikuara	3	3	10	4	2	2	3	2	5	2	2	1	1	6	2
Ndalesat e Paplanifikuara	3	3	0	6	4	3	3	2	4	4	4	5	4	3	6
Reniet	2	3	1	7	3	2	5	1	4	3	0	1	3	13	4
Gjithsejtë ndalesa	8	9	11	17	9	7	11	5	13	9	6	7	8	22	12

Tabela 5-Ndërprerjet e planifikuara dhe të paplanifikuara 2013-2015



3. Kostot Kapitale dhe Operative në Miniera

3.1 Investimet Kapitale

Në përcaktimin e të hyrave të lejuara maksimale, përveç shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes, koston së bartshme dhe koston kapitale, për gjeneratorët e rregulluar si komponentë e nevojshme është edhe lënda djegëse – thëngjilli.

Meqenëse KEK Gjenerimi nuk ka ndonjë marrëveshje për blerje të thëngjillit me KEK – Miniera, atëherë për çështje tarifore është marrë për bazë trajtimi i të gjitha kostove tek minierat njësoj sikurse tek të licencuarit TC Kosova A dhe TC Kosova B.

Duke krahasuar vlerat e realizuara me ato të lejuara për periudhën përkatëse, vërehet se në vitin 2013 në divizionin e prodhimit të thëngjillit janë realizuar 8.4 mil€ të investimeve kapitale nga 14.5 mil€, apo në normën prej 58 %; në vitin 2014 janë realizuar 10.4 mil€ të investimeve kapitale nga 39.5 mil€, në normën prej 26 % dhe në vitin 2015 janë realizuar 6.2 mil€ të investimeve kapitale nga 41.4 mil€, në normën prej 15 %.

Vlen të theksohet se për këtë periudhë janë lejuar rreth 96 mil€, ndërsa janë realizuar rreth 25 mil€ apo janë realizuar investimet kapitale në normën prej 26%.

Në tabelën e më poshtme është paraqitur plani investiv i realizuar nga Minierat në krahasim me atë të lejuar nga ZRRE-ja për secilin projekt në periudhën 2013 – 2015.



Emrat e projekteve	2013		2014		2015	
	Lejuar (€'000)	Aktual (€'000)	Lejuar (€'000)	Aktual (€'000)	Lejuar (€'000)	Aktual (€'000)
Kostot e Exproporimit te fshatit Hade	2,000	1,277		263		
Stacionet kthyese B=1600mm per shiritat e thengjillit –sistemi 1	327					
Renovimi i makinave të kombinuara për TC Adhe TC B	6,500		6,500	4,153	-	
Makinat e renda	3,682	1,242	2,455	186	2,455	949
Riparimi I dy eskavatoreve kompakt SRs1300, E-8B	-		16,000	-	29,000	-
Ndertesa per garderobe	1,000		-		-	
Shiritat e dyfishte transportues per SWS	-		15,000	-	10,000	0
Sistemi per kontrole nga distanca	1,000		-		-	
Tambura për konvejer B=1400; 1600; 1800				210		
Rregullimi i kulmit ne FPX ne pjesen e perpunimit me prerje				126		
Turno dozer				665		
Kamion bus për transportin e punëtorëve				193		
Eskavator hidraulik				280		
Kontrata te bartura nga viti paraprak				140		
Projektet tjera të prioritetit të lartë të realizuara gjatë vitit 2013, 2014 dhe 2015		5,920		4,223		989
Kontratat e bartura nga 2014						426
Pervehtesimi i tokave (eksproprijimi)						13
Makin. E kombinuara Sep. B						2,800
Furnizim me reduktor te levizjes rrethore SRs 470(dizajn i ri)						93
Furnizim me reduktor te kabines-I-SRs 470(dizajn I ri)						319
Kurora e dhembzuar dhe shtrati sferik SRs 470						109
Furnizim me tambura veprues te SRs(1300,650,470,400)						46
Elektromotor të kontrolluar me shëndrrues të frekuencave						250
Rregullimi i kulmit ne FPX ne pjesen e perpunimit me prerje						126
Largimi i ujrave sip.dhe rruget per qasje ne Deponin,,A''						67
Gjithsejtë	14,509	8,439	39,955	10,439	41,455	6,187

Tabela 6-CAPEX për miniera 2013-2015

Në vijimë janë paraqitur përshkrimet teknike, arsyeshmëria e projekteve, ndikimi në performancën e sistemit, objektivat dhe benefitet që arrihen me realizimin e investimeve kapitale:

- Projekti për zhvendosje të fshatit Hade ka qenë i paraparë të realizohet gjatë vitit 2013. Pjesa më e madhe e këtij projekti është realizuar gjatë vitit 2013 dhe një pjesë më e vogël është realizuar në vitet 2014 dhe është në progres të realizimit gjatë vitit 2016. Ky projekt ka rëndësi të madhe për zgjerimin e terrenit për eksploatim të thëngjillit. Miniera është duke u ballafaquar me rezistencë nga banorët e fshatrave Shipitull dhe Hade për të liruar hapësirat (pronat) e tyre për të vazhduar me planin e zgjerimit të minierës.
- Makinat e kombinuara ishin paraparë të realizohen gjatë vitit 2014 në shumë prej 6.5 mil€, ndërsa janë realizuar në shumë prej 4.1 mil€. Realizimi i këtij projekti ka ndikuar në përmirësimin e shërbimeve dhe ngritjen e sigurisë së furnizimit me thëngjill në drejtim të TC Kosova B.
- Makinaria e rëndë është planifikuar të realizohet në periudhën 2013 – 2015 në shumë prej 8.6 mil€, mirëpo deri më tani KEK miniera ka realizuar rreth 2.4 mil€ e që deri në



fund të vitit 2016 kjo vlerë pritet të jetë më e lartë. Qëllimi i këtij projekti është avancimi i disponueshmërisë drejtë furnizimit me thëngjill tek njësitë gjeneruese.

- Në periudhën 2014 – 2016, KEK ka identifikuar disa projekte të rëndësishme të lartë dhe të cilët është dashur të trajtohen me urgjencë me qëllim të përmirësimit të kushteve të furnizimit me thëngjill për njësitë gjeneruese dhe mbarëvajtje të prodhimit.
- Projekti i ndërtesës për gardërobe i paraparë të realizohet gjatë vitit 2013 nuk është realizuar gjatë asaj kohe për shkak të vështirësive financiare por që i njëjti është në proces për tu realizuar gjatë vitit 2016 eventualisht mund të shtyhet për vitin 2017.

Dy projekte madhore që janë planifikuar të investohen përgjatë periudhës 2013–2016 siç janë: “Riparimi i dy eskalatorëve” me vlerë të planifikuar të investimit prej 32.5 mil€ dhe “ Shiritat transportues” me vlerë të planifikuar të investimit prej 45 mil€ nuk janë realizuar. Këto dy projekte janë të rëndësishme të lartë për zgjerimin e miqjeve sipas Planit Xehetarë.

3.2 Shpenzimet operative në Miniera

Shpenzimet e përgjithshme operative të lejuara në Miniera për periudhën e raportuar 2013-2015 janë rreth 113.6 mil€, ndërsa realizimet janë 138.9 mil€ apo në normën prej 122 %.

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë detajet për shpenzimet operative të lejuara dhe realizuara sipas zërave për periudhën 2013- 2015.

Përshkrimi	Njesia	Lejuar 2013	Realizuar 2013	Lejuar 2014	Realizuar 2014	Lejuar 2015	Realizuar 2015	Lejuar 2013-2015	Realizuar 2013-2015	Realizimi %
Kostot e Personelit	€'000	22,986	29,796	21,027	31,343	20,011	32,691	64,024	93,830	147%
Derivate uji dhe gazi	€'000	2,897	3,275	2,700	2,587	2,448	1,957	8,045	7,819	97%
Riparimi mirëmbajtja	€'000	8,952	8,239	8,325	7,449	8,131	8,004	25,408	23,692	93%
Shpenzimet e transportit	€'000	237	188	220	122	214	102	671	412	61%
Shpenzimet e sigurimit	€'000	988	1,249	915	1,110	892	1,384	2,796	3,743	134%
Te tjera	€'000	4,471	3,444	4,140	2,829	4,035	3,195	12,646	9,468	75%
Total	€'000	40,533	46,191	37,326	45,440	35,731	47,333	113,590	138,964	122%

Tabela 7- Kostot e operimeve dhe të mirëmbajtjes Miniera

Shpenzimet në total kanë tejkalim përkundër caqeve të vendosura nga ZRRE përmes faktorit të efikasitetit prej 4%.



3.3 Prodhimi dhe konsumi i linjtit

Prodhimi dhe konsumi i linjtit nga TC-të dhe tregu për periudhën raportuese 2013- 2015 është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Prodhimi/konsumi i linjtit (ton)	Prodhimi i linjtit (ton)	Konsumi i linjtit nga TC-të (ton)	Konsumi i linjtit në treg (ton)
2013	8,219	8,904	192
2014	7,204	7,118	196
2015	8,241	8,143	224

Tabela 8-Prodhimi dhe konsumi i linjtit

Nga tabela vërehet se prodhimi i linjit është konstat ndër vite, por në vitin 2014 ka një rënie të prodhimit dhe konsumit si pasojë e aksidentit në TC Kosova A.